- Bashkia e Librazhdit do të sigurojë ambiente të përshtashme dhe automjetet për të bërë të mundur që të funksionojë shërbimi lëvizës në familje për moshën e tretë.
- Bashkia do të kryejë disa cikle kualifikimesh për personelet që do të angazhohen në ofrimin dhe vazhdimin e shërbimit lëvizës.

Anekse:

Bashkëlidhur, sipas nevojës, një përshkrim pune për konsulentë, terma reference për të kontraktuarit, specifikime teknike për pajisjet, formate të regjistrimit gjatë trajnimeve etj.

DocuSigned by:

Entela Lako

53E89C3E599942D...

Shoja 3
Kalendari i Aktiviteteve, Mjeteve dhe Pagesave
Viti 2023 – 2024

PRODUKTET E PRITSHME dhe treguesit, përfshirë synimet vjetore	AKTIVITETET E PLANIFIKUARA <i>Rendisni të gjitha aktivitetet që duhen ndërmarrë gjatë vitit për arritjen e rezultateve të shprehura</i>	Kalendari i punës 12 muaj				Pershkrimi i Buxhetit	Shuma ALL	Me firmosjen e marreveshjes	Pas dorezimit dhe pranimit të raportit Dhjetor 2023
		Q 1	Q 2	Q 3	Q 4				
Rezultati 1: Është ngritur struktura me staf psikosocial me qëllim ofrimin e shërbimeve komunitare dhe asistencën në banesë përmes njësisë levizëse	Aktiviteti 1.1: Rekrutimi i një kordinatori për aktivitetet e projektit	X				Pagesë për kordinatorin	810,828	405,414	405,414
Treguesit: 1. Numri i personelit të rekrutuar	Aktiviteti 1.2: Rekrutimi i një punonjësi social për shërbim komunitar dhe në banesë	X	X			Pagesa për punonjësin social	660,000	330,000	330,000
Rezultati 2: Ambientet e qendres ditore janë përshtatur, mobiluar për të ofruar shërbime midësore dhe njësisë levizëse është funksionale	Aktiviteti 2.1: Përshtatja dhe mobilimi i ambienteve për të ofruar shërbime shoqërore	X	X			Mobilimi i qendres	150,000	150,000	
Treguesit: 1. Ambiente dhe mjete të përshtatura për shërbime	Aktiviteti 2.2: Prokurim të mjeteve të nevojshme (automjet) për shërbimin levizës		X			Pagesa për automjet që do të kryejë shërbimin në banesë	600,000	600,000	
Rezultati 3: Hartuar modeli, fuqizuar kapacitet e strukturave, profesionistëve ofrues të shërbimeve sociale dhe të rinjve vullentarë duke siguruar	Aktiviteti 2.3: Shërbime transporti dhe mirembajtje		X	X	X	Pagesa për karburant (shpenzim i bashkisë)	0		
	Aktiviteti 3.1: Hartimi i një udhëzuesi praktik për modelin e shërbimit levizës		X			Pagesa për ekspertizë	200,000	200,000	
	Aktiviteti 3.2: Organizim i trajnimeve për kualifikimin e stafit (15 persona)	X	X			Pagesa për ekspertizë	50,000	50,000	

<p>mirëfunksionimin dhe ofrimin e shërbimeve shqetërore cilësore përmes shërbimit komunitar në qendër dhe në banesë për të moshuarit në nevojë</p> <p>Treguesit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i ekspertëve të rekrutuar 2. Numri i trajnimeve të kryera 3. Numri i pjesëmarrësve në trajnime 4. Numri i vizitave të kryera në familje 	Aktiviteti 3.3: Organizim i një kursi trajnimi 4 ditor për 20 të rinj.	X				Pagesa për ekspertizë	50,000	50,000		
	Aktiviteti 3.4: Organizimi i një trajnimi për 15 profesionistë		X			Shpenzime për catering dhe refreshments	64,000	64,000		
	Aktiviteti 3.5: Sigurimi i bazës materiale për trajnimet		X	X		Shpenzime për materiale	20,000	20,000		
	Aktiviteti 3.6: Aktivitete psikosociale		X	X	X	Shpenzime për refreshments	125,000	125,000		
	Aktiviteti 3.7: Ndihma për të moshuar të vetmuar me paketa higjienike		X	X	X	Shpenzime për paketa higjienike	200,000	200,000		
	Aktiviteti 3.8: Ndihma për të moshuar të vetmuar me paketa ushqimore		X	X	X	Shpenzime për vakte ushqimore (shpenzim i bashkisë)	0			
	Aktiviteti 3.9: Shpenzimi për ambientin	X	X	X	X	Pagesë qeraje(shpenzim i bashkisë)	0			
	Aktiviteti 3.10: Shpenzime mirëmbajtje	X	X	X	X	Pagesa mirëmbajtje (shpenzim i bashkisë)	0			
	Aktiviteti 3.11: Vizibiliteti	X	X	X	X	Shpenzime për vizibilitet	20,000	20,000		
	Total						2,997,828	2,262,414	735,414	

Shënim:

- Rregullimet brenda secilit prej seksioneve mund të bëhen në konsultime ndërmjet UNDP-së dhe Bashkisë së Librazhdit. Këto rregullime mund të bëhen nëse ato janë në përputhje me dispoziat e Programit Mbështetës/Dokumenit e Projektit dhe nëse gjykohet se ato janë në interesin më të mirë të projektit.

Ju lënëni ofroni detajet e nevojshme për të treguar si kemi artur në shumat e deklaruar. Ju lënëni fshini rreshtat dhe zero-t që nuk janë të nevojshme, dhe në pas-logaritëni shumat.

Nr.	Përshkrimi i zërave të buxhetit	Njësia (p.sh. cope, orë, ditë pune,	Sasia	Kosto për njësi ne Lek	Kosto totale ne Lek	Kontributi i kerkuar nga LNB	Kontributi i vet (nëse ka)
1	Burimet njerëzore						
1.1	Koordinator i shtetbimeve	muaj	12	67,569	810,828	810,828	
1.2	Punonjës social	muaj	12	55,000	660,000	660,000	
	Non totali				1,470,828	1,470,828	
2	Politikat dhe kuzhinat						
2.1	Mobilimi i gendës së shtetbimeve komunitare dhe asistencës në banesë	lump sum	1	150,000	150,000	150,000	
2.2	Automjetet për ofrimin e shtetbimeve	vehicle	1	600,000	600,000	600,000	
2.3	Karburant	muaj	12	15,000	180,000	180,000	180,000
	Non totali				930,000	750,000	180,000
3	Shpenzime për aktivitetet (sipas planit të punës)						
3.1	Ekspert për hartimin e udhëzimit praktik	Ditë pure	20	10,000	200,000	200,000	
3.2	Shtetbimet e konsulcencës (Ekspert 1)	Ditë pure	5	10,000	50,000	50,000	
3.3	Shtetbimet e konsulcencës (Ekspert 2)	Ditë pure	5	10,000	50,000	50,000	
3.4	Katering dhe pushim kafaje trajnimi 1 (15 persona x 4 ditë x 800)	dite	60	800	48,000	48,000	
3.5	Katering dhe pushim kafaje trajnimi 2 (20 persona x 4 ditë x 800)	dite	80	800	64,000	64,000	
3.6	Baze materiale për trajnimet	lumpsum	1	20,000	20,000	20,000	
3.7	Aktivitetet psiko-sociale	lumpsum	25	5,000	125,000	125,000	
3.8	Ndihme direkte për 20 të moshuar të veprimtarë duke ofruar paketa të higjienike	rasë	100	2,000	200,000	200,000	
3.9	Vakti ushqimor në banesë për 20 raste për 10 muaj x 15ditë/muaj	rasë	3,000	350	1,050,000		1,050,000
3.10	Cera salla për qendrat komunitare	muaj	12	12,000	144,000		144,000
3.11	Ujë dhe energji e gendës komunitare	muaj	12	8,000	96,000		96,000
	Non totali				2,047,000	757,000	1,290,000
4	Vizibiliteti, botime, përthime, etj.						
4.1	Dizajni, Foto, video për mediat sociale	lumpsum			20,000	20,000	
	Non totali				20,000	20,000	
I	SHPENZIME DIREKTE (Nr. 1 - 4)				4,467,828	2,997,828	1,470,000
II	Shpenzime tjera (indirekte) (maksimumi 10% e totalit të shpenzimeve						
	Non totali						
	TOTALI (e)				4,467,828	2,997,828	1,470,000

Financimi:	UNDP dhe Bashkia Librazhd
Buxheti detajuar:	4,467,828 LEK Shqiptare
Titulli Projektit:	Titulli " Mbeshtetje për të moshuarit në nevojë përmes shtetbimeve komunitare dhe asistencës në banesë."
Kohëzgjatja e Projektit:	12 muaj
Bashkia:	Bashkia Librazhd
	Të gjitha në lek
	Kostot Totale 4,467,828 LEK 100%
	Kontributi 2,997,828 LEK 67%
	Kontributi i vet 1,470,000 LEK 33%
	Kontributi nga partnerët të tjerë 0



P/V
3



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA LIBRAZH D
KRYETARI

P/ VENDIM

NR ____ DATE ____ / ____ /2023

“PER MIRATIMIN E MARREVESHJES SE BASHKEPUNIMIT KIA GREEN LIGHT
PROJEKT”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “ neni 54 pika dh ,të Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore “, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë “, i ndryshuar , në Udhëzimin Nr.2 Datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, udhezimin nr. 9 date 20.03.2018 “ Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit” ,Udhezimi plotesues nr.2 date 19.01.2023 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2023” ,VKB nr. 107,date 28.12.2022 “ Për miratimin e Buxhetit të vitit 2023 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2023-2025” ,“Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë ____/10/2023 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI :

1. Të miratojë Marrëveshje bashkëpunimi për projektin “Kia Green Light Project” nr.6061prot date 19.09.2023 midis Bashkisë Librazhd - World Vision Albania me një vlerë të plotë prej **41,082,981** lekë , per periudhën 01.09.2023 – 31.03.2028 (pesë vite).
2. Të miratojë financimin e këtij projekti nga World Vision Albania në vlerën **30,336,222** lekë nga të cilat 2,984,710 lekë do menaxhohen nga bashkia per periudhen shtator 2023 – korrik 2025 dhe 27,351,512 lekë do menaxhohen nga vetë W-Vizion ,per periudhen 01.09.2023 – 31.12.2025.
3. Të miratojë financimin e këtij projekti nga Bashkia Librazhd në vlerën **10,746,759** lekë nga të cilat 5,215,392 lekë do perdoren për paga dhe sigurime për personelin periudha shtator 2023- dhjetor 2025 dhe 5,531,367 lekë do përdoret për shërbim dhe mirëmbajtje , per periudhen shtator 2023- dhjetor 2025 .
4. Të miratojë përdorimin e fondit të financuar nga World Vision Albania për periudhën shtator 2023 – korrik 2025 në vlerën **2,984,710** lekë në strukturën buxhetore si më poshtë:

•	Kodi i institucionit	Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera ne leke
	2 128 001	00	10430	06	600	2,557,600 leke
	2 128 001	00	10430	06	601	427,110 leke

5. Te miratoje perdorimin e fondit te financuar nga Bashkia per paga dhe sigurime ne vleren **5,215,392** leke për periudhën shtator 2023 – dhjetor 2025 në strukturën buxhetore si më poshtë:

Kodi i institucionit	Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera ne leke
2 128 001	00	10430	01	600	4,469,080 lekë
2 128 001	00	10430	01	601	746,312 lekë

Për periudhën shtator 2023- dhjetor 2023 fondet janë të miratuara në buxhetin e vitit 2023 me v.k.b nr.107 datë28.12.2022 dhe konfirmim nga Prefektura nr.25/1 datë 13.01.2023.

- 5.1 Te miratoje perdorimin e fondit te financuar nga Bashkia **5,531,367** leke për periudhën shtator 2023 – dhjetor 2025 per shpenzime operative dhe kapitale ne strukturen buxhetore si më poshtë:

Kodi i institucionit	Grupi	Tit.	Kap.	Art .	vlera
2 128 001	00	10430	01	602	1,224,972 leke shpenzime drita ,uje,internet

Kodi i institucionit	Grupi	Tit.	Kap.	Art .	vlera
2 128 001	00	10430	01	602	116,676 leke shpenzime detergjente per pastrim

Kodi i institucionit	Grupi	Tit.	Kap.	Art	vlera
2 128 001	00	10430	01	602	303,324 leke shpenzime mirembajtje makine goma pjese xhenerike,larje makine.

Kodi i institucionit	Grupi	Tit.	Kap.	Art .	vlera
2 128 001	00	10430	01	231	3,886,395 leke Rikonstruksion i Qendres per vitin 2024.

Për periudhën shtator 2023- dhjetor 2023 fondet për shpenzime operative janë të miratuara në buxhetin e vitit 2023 me v.k.b nr.107 datë28.12.2022 dhe konfirmim nga Prefektura nr.25/1 datë 13.01.2023.

6. Ndjek zbatimin e ketij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar , Sektori i Burimeve Njerezore dhe Sektori Juridik .
7. Ky vendim hyne ne fuqi 10 dite pas shpalljes

KRYETARI I BASHKISE

Mariglen Disha

f.



Nr. 6061 Prot.

Dt. 19/09 2023

Nr. 117 Prot.

Dt. / / 2023

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
PËR
Kia - Green Light Project**

Për ngritjen e Qendës Komunitare Multi- Funktionale Kia Green Light Project dhe ofrimin e shërbimeve psiko-sociale dhe mjekësore për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre, shërbime psiko-sociale për të rinjtë, trajnime për prindërit e rinj dhe specialistët, shërbim i integruar lëvizës dhe zgjerim i aktiviteteve fitimprurëse për familjet.

Nr. Marrëveshjes:	6 (gjashtë)
Titulli i projektit:	Kia Green Light Project
Institucioni zbatues:	World Vision Albania
Periudha e Projektit:	01/09/2023 - 31/03/2028 (pesë vite)
Buxheti Total i Projektit	41,082,981 (dyzet e një milion e tetëdhjet e dy mijë e nentëqind e tetëdhjet e një lekë)
Kontributi i World Vision Albania:	30,336,222 (tridhjetë milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e njëzet e dy lekë)
Kontributi i Bashkisë Librazhd:	10,746,759 (dhjetë milion e shtatëqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë lekë)

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi, nënshkruhet sot me datë / / 2023, nga dhe ndërmjet palëve të mëposhtme:

WORLD VISION ALBANIA, një organizatë jofitimprurëse, regjistruar në formën e Fondacionit, sipas Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr. 2544, datë 09/09/1999, identifikuar me NIPT J92127018B, me seli në Rr. "Skënderbej", Tiranë, përfaqësuar nga Znj. Eljona Elmazi, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv, (referuar si "**WVA**")

dhe

BASHKIA LIBRAZHËD, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, Z. Mariglen Disha, identifikuar me NUIS: K57904611M, (referuar si "**Bashkia**")

Palët e kësaj Marrëveshje në vijim do të referohen së bashku si "**Palët**" dhe veçmas si "**Pala**".





Palët, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, veçanërisht në Kodin Civil të RSH si dhe me frymën e besimit, respektit dhe përgjegjësisë së ndërsjellë, pranojnë të nënshkruajnë këtë Marrëveshje, sipas kushteve dhe afateve të mëposhtme.

DEKLARIME PARAPRAKE DHE PARIMET E PARTNERITETIT

- A.** Duke qenë se Bashkia ka në përdorim të saj pasurinë e ndodhur në Lagjen Nr 2, në Zonën Kadastrale Nr. 2446, me nr. pasurie 7/19 e llojit ndërtesë 2 (dy) katëshe, me sipërfaqe ndërtimore 371 m2 dhe sipërfaqe trualli 1552 m2, sic rezulton nga çertifikata e pronës nr. 143844 datë 19.07.2016, pasuri e cila do të rikonstruktohet që të shërbejë si ambjente pune për Drejtorinë e Shërbimeve Shoqërore të Bashkisë dhe po ashtu Qendër Multifunkionale për fëmijët, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre që kanë nevojë për shërbime të specializuara dhe të integruara në Bashki.
- B.** Duke qenë se Ambjenti i sipërcituar (godina e Shërbimit Social Shtetëror) përdoret nga Bashkia si ambient zyrash për Drejtorinë e Shërbimit Social Shtetëror, përmes grantit Kia -Green Light Project (Kia - GLP) të financuar nga Kia, dhe implementuar nga Fondacioni "WVA", në bashkëpunim me World Vision Korea dhe Bashkia, ky ambient do të rikonstruktohet dhe do të shërbejë si Qendër Komunitare Multi- Funkionale me qëllim përmirësimin e situatës shëndetësore dhe mirëqenies së banorëve të Librazhdit. Në Qendrën Komunitare Multifunkionale Kia Green Light Project do të ofrohen shërbime psiko-sociale dhe mjekësore për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre, shërbime psiko-sociale për të rinjtë, trajnime për prindërit e rinj dhe profesionalistët, shërbim i integruar lëvizës dhe zgjerim i aktiviteteve fitimprurëse për familjet, përgjatë afatit të implementimit të kësaj Marrëveshje.
- E.** Duke qenë se Bashkia ka në prioritetet e saj përmirësimin e shërbimeve të specializuara dhe të integruara për fëmijët me aftësi të kufizuara, shërbimet psiko-sociale për të rinjtë dhe banorët e Librazhdit, bashkëpunon me WVA, e cila është një organizatë jo-fitimprurëse, e regjistruar në formën e fondacionit, që ushtron veprimtarinë e saj duke pasur në fokus zhvillimin dhe mbështetjen afatgjatë për fëmijët, të rinjtë dhe familjet më në nevojë.
- F.** Duke qenë se në zbatim të parashikimeve aktuale statutore, WVA do të ofrojë kontributin e saj, duke financuar shumat monetare dhe zërat e përcaktuar në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, përmes investimit nga donatori kryesor Kia dhe implementimit nga vetë WVA në bashkëpunim me World Vision Korea, që do të kontribuojnë në favor të këtij projekti, si do të specifikohet më poshtë.

Për sa më sipër, Palët sëbashku bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (këtu e më poshtë referuar si "**Marrëveshja**"), si më poshtë vijon:

NENI 1 BAZA LIGJORE

Ligji nr. 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligji nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", VKM nr. 658, datë



17.10.2005 "Për standardet e shërbimeve shoqërore", VKM nr. 564, datë 12.8.2005 "Për Licencimin e ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore", i ndryshuar, Udhëzimi nr 355, datë 02.06.2022 " Për miratimin e standarteve të shërbimit lëvizës në familje, për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre dhe manuali i zbatimit", si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre.

NENI 2 QËLLIMI I MARRËVESHJES

Përmes kësaj Marrëveshje, Palët kanë për qëllim të përcaktojnë mënyrën dhe kufijtë e bashkëpunimit mes tyre, përgjegjësitë dhe rolin e secilës Palë në drejtim të zhvillimit, ruajtjes, mirëmbajtjes, mirë administrimit si dhe kryerjes së financimit për Qendrën Komunitare Multifunkionale KIA Green Light Project përgjatë afatit të implementimit të kësaj Marrëveshjeje, si do të përcaktohen më poshtë.

NENI 3 AFATI I MARRËVESHJES

- 3.1. Kohëzgjatja e zbatimit të Marrëveshjes do të jetë 01/09/2023 deri në 31/03/2028.
- 3.2. Bashkia dhe WVA bien dakord për të vijuar bashkëpunimin ndërmjet tyre dhe siguruar qëndrueshmërinë e shërbimit përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zbatimit të Marrëveshjes të financimit të projektit nga "Kia Green Light Project - Qendër Komunitare Multifunkionale për fëmijët, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre që kanë nevojë për shërbime të specializuara dhe të integruara", bazuar në rezultatet e arritura dhe objektivat gjatë afatit të implementimit të kësaj Marrëveshjeje, të matura sipas përcaktimeve të Nenit 6, më poshtë.

NENI 4 SHËRBIMET DHE ORGANIZIMI

4.1 Shërbimet që do të ofrohen në qendër

- 4.1.1 Shërbime shëndetësore dhe psiko-sociale për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre.
- 4.1.2 Shërbim i integruar lëvizës për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara;
- 4.1.3 Aktivitete psiko-sociale me të rinjtë si në qendër dhe në komunitet;
- 4.1.4 Trajnime për stafe mjekësore dhe punonjës të shërbimit psiko-social mbi zhvillimin e fëmijëve, punën me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çfarë teknikash duhet të përdoren;
- 4.1.5 Trajnime të prindërve të rinj mbi zhvillimin e fëmijëve dhe identifikimin e hershëm të aftësisë së kufizuar tek fëmijët për ndërhyrje të hershme;
- 4.1.6 Mbështetje të aktiviteteve të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara për të gjeneruar më shumë të ardhura për familjen.

4.2 Stafi, organizimi i punonjësve:

- 4.2.1 Stafi i qendrës përbëhet nga:





- Koordinator i Qendrës	1
- Psikolog	2
- Fizioterapist	1
- Logopedist	1
- Punonjes Social	1
- Shofer	1

4.2.2 Stafi psiko-social (koordinatori i qendrës/punonjës social dhe psikolog) dhe personeli mjekësor (logopedist, fizioterapist) do të angazhohen në bazë të marrëveshjes kontraktuale me Bashkinë. Ata do të punojnë në bazë të një kalendari aktiviteteesh (2-3 ditë në qendër dhe 2-3 ditë në shtëpinë e fëmijëve) sipas nevojave. Ekipi i shërbimit lëvizës (së Bashkisë) së bashku me psikologun dhe punonjës social të Qendrës Kia-GLP do të punojnë ngushtë me njëri – tjetrin. Ata do të ulen periodikisht, së bashku për të rishikuar planet dhe për të rivlerësuar nevojat e fëmijëve nga një perspektivë biopsikosociale. Pagesat për shërbimet e tyre do të bazohen në tarifat e pagave të Bashkisë.

4.2.3 Shpenzimet do të ndahen ndërmjet WVA dhe Bashkisë. Projekti WVA përmes projektit Kia - GLP do të mbulojë pagesat e Koordinatorit të qendrës, psikologut (stafe të qendrës) dhe pediatrit të zhvillimit i cili do të kontraktohet në baza periodike nga WVA. WVA do të transferojë fonde Bashkisë për mbulimin e pagave të dy punonjësve të ekipit lëvizës (logopedit dhe fizioterapistit), të cilët së bashku me stafet: punonjës social, një psikolog dhe një shofer, anëtarë të ekipit lëvizës, të mbuluar financiarisht me kontribut të Bashkisë, formojnë ekipin e plotë. Shoferi do të ndihmojë gjithashtu në transportimin e fermerëve për të shitur produktet e tyre.

4.2.4 Përshkrimet e punës për punonjësit e Qendrës Komunitare Multifunkionale Kia-GLP do të hartohen nga WVA në bashkëpunim me Bashkinë.

4.2.5 Të drejtat dhe detyrimet e stafit, kohëzgjatja e orëve të punës, janë përcaktuar në Kontratën Individuale të punës për secilin punonjës.

4.2.6 Kontratat e punës së stafit të qendrës lidhen nga WVA, ndërsa kontratat e logopedistit dhe fizioterapistit lidhen nga Bashkia, sipas dispozitave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë.

4.3. Taksat dhe detyrimet

Palët kanë përgjegjësinë e pagesës së të gjitha taksave të zbatueshme në përputhje me Legjislacionin e punësimit në fuqi në Shqipëri për stafin përkatës nën kontratë punësimi.

NENI 5 MËNYRA E ZBATIMIT TË MARRËVESHJES

5.1. WVA dhe Bashkia angazhohen respektivisht për të siguruar mirëfunktionimin e Qendrës Kia Green Light Project, si një qendër komunitare multifunkionale, ku do të ofrohen shërbime shëndetësore dhe psiko-sociale për fëmijë, të rinj me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre, për profesionalistët dhe prindërit e rinj, shërbimi integruar lëvizës dhe zgjerimit të aktiviteteve fitimprurëse për familjet.



- 5.2 Me qëllim funksionimin e Qendrës Kia - GLP përgjatë periudhës së kësaj Marrëveshje, Bashkia dhe WVA do të kontribuojë shumën totale prej **41,082,981** (dyzet e një milion e tetëdhjet e dy mijë e nentëqind e tetëdhjet e një lekë) lekë, sipas zërave të detajuar në Tabelën "Buxheti", Aneksi 1.
- 5.2.1 **KONTRIBUTI I WVA përmes Grantit të Kia** - për periudhën e financuar nga Kia do të jetë në shumën totale prej **30,336,222** (tridhjetë milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e njëzet e dy lekë) Lekë e shpërndarë kjo në zërat e detajuar në Aneksin 1. Po ashtu, WVA do të vendosë në dispozicion të shërbimeve automjetin për vizitat dhe shërbimet e terapisë në kushtet e shtëpisë, sikundër dhe për lëvizje të stafit të Qendrës gjithmonë sipas nevojës. Automjeti do të parkohet pranë ambjentit të jashtëm të Qendrës Multifunkionale - Kia GLP dhe çdo lëvizje e tij do të miratohet nga Manaxheri i Projektit.
- 5.2.2. **KONTRIBUTI I Bashkisë** do të jetë në shumën totale prej **10,746,759** (dhjetëmilion e shtatëqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) Lekë, i shpërndarë në zërat e detajuar në Aneksin 1.
- 5.2.3. Në çdo rast, Palët kanë të drejtë që në varësi të nevojave për investime në zëra të caktuar, të përcaktojnë apo ndryshojnë shpërndarjen e Investimeve respektive, duke i kanalizuar ato në zëra të tjerë apo në zëra të ndryshëm nga sa më sipër, por në çdo rast pa tejkalluar angazhimin monetar të përcaktuar në këtë nen si dhe vetëm me marrëveshje me shkrim ndërmjet tyre.
- 5.3. Lidhur sa më sipër, WVA dhe Bashkia bien dakord që të shfrytëzojnë eksperiencën dhe njohuritë e WVA-së, duke i njohur kësaj të fundit të drejtën të menaxhojë axhendën e aktiviteteve të përditshme të Qendrës Komunitare Multifunkionale të Kia GLP (të miratuar paraprakisht nga Bashkia), duke mundësuar dhe organizuar aty shërbime shëndetësore dhe psiko-sociale, aktivitete psiko-sociale, trajnime për të rinjtë, prindërit e rinj dhe profesionalistët, shërbimin e integruar lëvizës dhe zgjerimin e aktiviteteve fitimprurëse për familjet.
- 5.4. WVA do të realizojë Shërbimet me financimin e grantit Kia GLP, për t'i përdorur në funksion të Qendrës, sipas qëllimit/shërbimit specifik për të cilin është përfituar granti.
- 5.5. Lidhur me menaxhimin e aktiviteteve të përditshme në Qendër, WVA në bashkëpunim me Bashkinë, do të të koordinojë dhe menaxhojë stafin e Qendrës (punëmarrës, staf të WVA etj) duke përcaktuar për secilin rolin, përgjegjësitë dhe detyrat, lidhur me çdo aktivitet të organizuar në Qendër.

NENI 6 INDIKATORËT E PERFORMANCËS

- 6.1. Referuar përcaktimeve të nenit 3.2. të kësaj Marrëveshje, në fund të çdo viti implementimi, Palët do të angazhohen respektivisht për të matur performancën e implementimit të kësaj Marrëveshje nga WVA. Performanca do të matet sipas indikatorëve të performancës. Indikatorët e Performancës nënkuptojnë dhe përbëhen nga evidencat/rezultatet e realizimit





të objektivave nga WVA, siç ato janë paracaktuar në projekt deri në përfundim të afatit të përcaktuar. Konkretisht, Palët përcaktojnë dhe bien dakord se:

6.1.1 Objektivat për tu arritur nga WVA deri në përfundim të afatit të implementimit të Marrëveshjes janë:

Objektivi 1: Një Qendër Komunitare Multifunkionale rikonstruktohet dhe përshtatet për ofrim shërbimesh dhe një mjet transporti blihet dhe përshtatet për të ofruar shërbimet në terren.

Objektivi 2: Fëmijët, të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe prindërit/kujdestarët e tyre, ashtu si dhe 1500 femije dhe të rinj të tjerë përfitojnë nga shërbimet mjekësore dhe psiko-sociale të ofruara në qendrën GLP dhe nëpërmjet shërbimit lëvizës në mjediset e shtëpisë.

Objektivi 3: Fermerët/familjarët e fëmijëve që frekuentojnë shërbimet në qendër ose ato lëvizëse mbështeten në zgjerimin e aktiviteteve të tyre bujqësore për të gjeneruar të ardhura që në të ardhmen të mund të vetëmbështetin frekuentimin e qendrës nga fëmijët/familjarët e tyre.

6.1.2 Mënyrat e matjes (mjetet e verifikimit) të rezultateve janë:

- (i) përmes analizës statistikore;
- (ii) përmes pyetësoreve drejtuar fëmijeve;
- (iii) përmes pyetësoreve drejtuar adultëve.

6.2. Matja e rezultateve sipas Indikatorëve të performancës, do të bëhet mbi bazën e të dhënave sasiore dhe statistikore të mbajtura gjatë gjithë vitit nga WVA.

6.3. Bashkia dhe WVA bien dakord respektivisht të konsiderojnë vijimin e bashkëpunimit me WVA pas kalimit të afatit 5-vjeçar të kësaj Marrëveshje, nevojave si edhe kërkesave të projektit dhe të buxhetit.

6.4. Në rast se Palët do të vijojnë bashkëpunimin mes tyre, sipas parashikimeve të këtij neni, Investimi i grantit të Kia-GLP nga KIA Motors implementuar nga WVA, do të njihet si kapital/kontribut i WVA, në bashkëpunimin që mund të vijojë në të ardhmen midis Palëve, pavarësisht formës së bashkëpunimit apo kontratës/marrëveshjes/dokumentit në të cilën do të materializohet ky bashkëpunim. Në konsideratë të këtij parashikimi, Bashkia bie dakord të evidentojnë këtë Investim të WVA në kontratën/marrëveshjen/dokumentin që do të rregullojë formën e bashkëpunimit mes Palëve në të ardhmen.

NENI 7 DETYRIMET E WVA

7.1. WVA detyrohet të ndërmarrë të gjitha masat për të manaxhuar në kohë dhe pa vonesa Investimin e saj prej **30,336,222** (tridhjetë milion e treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e dyqind e njëzet e dy lekë) Lekë të shtrirë në tre vite implementim (ndjekur nga dy vite monitorim), të kësaj Marrëveshje, sipas zërave të përcaktuar në aneksin bashkëlidhur saj, apo



siç këto zëra mund të ndryshohen me marrëveshje mes Palëve, duke pasur në konsiderate nevoja specifike për investime në Qendër të cilat nuk janë parashikuar në këtë Marrëveshje.

- 7.2. WVA do të bashkëpunojë me Bashkinë në të gjitha etapat e zbatimit të projektit, përzgjedhjen e fëmijëve, trajnimin dhe mentorimin e stafit të specialistëve, ecurinë e fëmijëve, ecurinë e vizitave në famije, informimin mbi elementët e angazhimit komunitar.
- 7.3. WVA do të përpilojë plane pune, mujore për Aktivitetet që do të kryhen në Qendër, të cilat do të ndahen me drejtorinë e shërbimit social shtetëror.
- 7.4. WVA ka përgjegjësinë e respektimit të Dispozitave të Përgjithshme, ndarjes së detyrave, liste-prezencës dhe elementë të tjerë që ka të bëjë me marrëdhëniet e punës.
- 7.5. WVA do të sigurojë infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme për zbatimin e këtij projekti siç janë materialet e punës dhe automjeti për ekipin lëvizës.
- 7.6. WVA do të sigurojë mjetin e transportit (naftë, mirëmbajtje mjeti etj) dhe të gjitha kostot e nevojshme për të, duke mundësuar transport të sigurt për ekipin e specialistëve dhe fëmijëve të përfshirë në projekt.
- 7.7. WVA do të hartojë raporte dhe do të mbajë të informuar Bashkinë nëpërmjet komunikimeve shkresore, për veprimtaritë e realizuara në Qendrën Komunitare Multifunkionale Kia Green Light Project.
- 7.8. WVA do të dakordësohet me Bashkinë mbi vendin dhe format e dokumentimit të shërbimit lëvizës.
- 7.9. Në përfundim të projektit, përfshirë kohëzgjatjet sipas dakordësimit me donatorin, WVA mban përgjegjësinë e transferimit të aseteve të projektit (mobiljet, mjeti i transportit, paisjet IT) Bashkisë.
- 7.10. WVA merr përsipër mbulimin e të gjitha detyrimeve financiare, duke përfshirë këtu transfertën e fondeve për pagën e dy punonjësve fizioterapist dhe logopedist, me qëllim zbatimin e projektit, sipas zërave të detajuar në Tabelën "Buxheti për rrogat", Aneksi 2.
- 7.11. WVA ka të drejtën e monitorimit të vijueshmërisë së projektit, të shërbimit dhe të mirëmbajtjes së qendrës dhe aseteve që do të dhurohen edhe 2 (dy) vite pas përfundimit të mbështetjes financiare.

NENI 8 DETYRIMET E BASHKISË LIBRAZH

- 8.1. Bashkia do të angazhohet të ndërmarrë çdo veprim të nevojshëm ligjor, për lehtësimin e procedurave lidhur me kërkesat e WVA, në shërbim të funksionimit normal të Qendrës Kia-GLP, sipas përcaktimeve në këtë Marrëveshje, si dhe çdo marrëveshje tjetër të lidhur në zbatim të saj.





- 8.2. Si mbajtëse e të drejtës ligjore së përdorimit të hapësirës së Qendrës Kia- GLP, ka detyrimin të lejojë WVA, të ketë akses të plotë dhe të pakufizuar në hapësirat e Qendrës, të vendosura në dispozicion të shërbimit multifunksional.
- 8.3. Bashkia do të ndërmarrë të gjitha masat për të manaxhuar në kohë dhe pa vonesa investimin e saj në shumën prej **10,746,759** (dhjetë milion e shtatëqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e nëntë) Lekë gjatë implementimit të kësaj Marrëveshje, si dhe anekseve bashkëlidhur saj, apo siç këto zëra mund të ndryshohen me marrëveshje mes Palëve, duke pasur në konsideratë nevoja specifike për investime në Qendër të cilat nuk janë parashikuar në këtë Marrëveshje.
- 8.4 Bashkia të përdorë në mënyrë efektive burimet e siguruar nga WVA, si bazë materiale (si për Qendrën Kia- GLP, por dhe për ambientet e përdorura nga Shërbimi Social Shtetëror) sikundër për çdo gjë që lidhet me zbatimin e projektit në përputhje me dokumentat e projektit, marrëveshjes dhe kontratës.
- 8.5 Bashkia duhet të kryejë pagesën mujore, përfshi këtu çdo detyrim tjetër financiar sipas ligjit të punësimin për stafin e shërbimit lëvizës.
- 8.6 Bashkia do të lehtësojë zbatimin e projektit me kujdes, efikasitet, transparencë dhe zellin e kërkuar dhe me praktikën më të mirë në sektor dhe në fushën e ndërhyrjes.
- 8.7 Bashkia dakordësohet me WVA mbi vendin dhe format e dokumentimit të shërbimit lëvizës.
- 8.8 Bashkia siguron lejet e nevojshme për punimet që do të kryhen për rikonstruksionin e godinës.
- 8.9 Bashkia do të mbulojë shpenzimet në ujë dhe drita si dhe shërbimin sanitar për të gjithë godinën, sikundër do të sigurojë staf sigurie për godinën.
- 8.10 Bashkia është përgjegjëse për kualitetin e punimeve që do të kryhen për rikonstruksionin e godinës për qendrën Kia-GLP.
- 8.11 Bashkia është përgjegjëse për vazhdimin dhe mbështetjen e shërbimeve dhe aktiviteteve që do të organizohen në qendrën Kia-GLP edhe pas përfundimit të mbështetjes financiare nga World Vision Albania.

Neni 9:

KUSHTI I TRASFERIMIT TË FONDEVE

1. Trasferimi i fondeve sipas kësaj Marrëveshje kryhet me kusht në kuptim të nenit 768 të Kodit Civil. Kushti i transferimit lidhet me përdorimin ekskluziv të Fondit vetëm për pagesën e specialistëve të ekipit lëvizës. ("Kushti")
2. Me qëllim vërtetimit e realizimit të "Kushtit":



2.1. Fondi do të transferohet tek Bashkia në formën e katër kestëve, në formë parafinancimi dhe rimbussim të kombinuar, në bazë të Udhëzimeve të Partneritetit Financiar të World Vision Albania.

2.1.1. Kësti i parë: 389,310 ALL (lek), në datë 22 Tetor 2023 në formë parafinancimi.

2.1.2. Kësti i dytë: 778,620 ALL (lek), në datë 22 Janar 2024 në formë parafinancimi.

2.1.3. Kësti i tretë: 778,620 ALL (lek), në datë 22 Korrik 2024 në formë parafinancimi.

2.1.4. Kësti i katërt: 1,038,160 ALL (lek), në datë 22 Janar 2025 në formë parafinancimi.

2.2. World Vision Albania do të paraqesë tek Bashkia dokumentat përkatëse për pagesën e stafit të shërbimit lëvizës komunitar, sipas kërkesave të Bashkisë.

2.3 Në 15 Janar 2023, 12 Korrik 2024, 15 Janar 2025 dhe 15 Shtator 2025 Bashkia Librazhd do t'i paraqesë World Vision Albania informacion në lidhje me pagesat e stafit të shërbimit lëvizës sipas ligjit të punësimit dhe shpenzimin e fondit të kaluar nga World Vision Albania.

2.4 Dokumentat të vlefshme që vërtetojnë pagesat e stafit tek World Vision Albania janë bordero; pagesa e sigurimeve; transferata bankare që vërteton pagesën e stafit, kjo referuar ligjit shqiptar.

2.5 Nëse një nga punonjësit nuk plotëson kushtet sipas marrëveshjes së punës apo jep dorëheqjen për arsye të ndryshme fondi i transferuar në Bashkinë Librazhd me këtë "Kusht" kthehet tek World Vision Albania.

2.6 Nëse projekti dështon për arsye madhore të cilat cojnë në prishje të marrëveshjes fondi i transferuar në dëgen e thesarit të Bashkisë Librazhd me këtë "Kusht" kthehet tek World Vision Albania.

3. Fondi do të transferohet në llogarinë e mëposhtme bankare të Bashkisë:

TIRANA BANK, Dega Librazhd:
AL 43 2063 4012 0001 5003 2000 0100
Dega e thesarit: Bashkia Librazhd
Nr i Logarisë: 1500-320000-100

4. Komisionet bankare do të mbulohen nga World Vision Albania.

NENI 10 DEKLARIME DHE GARANCI TË PALËVE

10.1. Kjo Marrëveshje bazohet në vizionet e përbashkëta të WVA dhe Bashkisë, që "Fëmijët me aftësi të kufizuar të përfitojnë përkudësjen maksimale nëpërmjet marrjes së shërbimeve të përkudësjes shoqërore, asistencës shtëpiake dhe detyrimit që ka pushteti vendor ndaj shërbimeve për mirëqënien e fëmijeve në zonën e Librazhdit, sipas pikës 10 të Udhëzimit nr.597, datë 22.12.2017 "Për miratimin e standarteve të shërbimeve të përkudësjes shoqërore, asistencës shtëpiake, për personat me aftësi të kufizuar".





- 10.2. WVA dhe Bashkia pranojnë se kjo Marrëveshje do të bazohet në parimet e zhvillimit të komunitetit dhe përfshirjes sociale dhe do të nxitet prej tyre. Ata përkushtohen që të krijojnë vullnet të mirë, besim dhe mirëkuptim reciprok në çdo rast të mundshëm, si dhe të identifikojnë, dokumentojnë dhe zbatojnë praktikën e mira të partneritetit duke siguruar kështu suksesin të partneritetit.
- 10.3. Bashkia deklaron dhe garanton se është i vetmi përdorues i ligjshëm i ambjentit, dhe në këtë cilësi ka të drejtë të lidhë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi dhe/ose çdo marrëveshje tjetër që mund të lidhet për nevojat të zbatimit të kësaj të fundit.
- 10.4. Palët deklarojnë se do të vendosin në dispozicion të njëra tjetrës çdo dokument ligjor apo financiar që do të kërkohet nga to, për zbatimin e kësaj Marrëveshje dhe/ose çdo marrëveshje tjetër të lidhur në zbatim të saj.
- 10.5. Palët deklarojnë se do të raportojnë respektivisht dhe do të mbajnë të informuar njëra tjetrën, për çdo veprimtari apo procedurë të ndërmarrë nga secila prej tyre në funksion të Qëllimit të kësaj Marrëveshje.
- 10.6. Secila Palë do të ketë përgjegjësinë për t'u përputhur me legjislacionin ose rregullat në fuqi kur të kryejë punë dhe veprimtari të tjera nën këtë Marrëveshje dhe nën çdo akt ligjor apo nënligjor të zbatueshëm ndaj secilës Palë.
- 10.7. WVA ka të drejtë të monitorojë përdorimin e Investimit të saj nga Bashkia, duke pasur të drejtë të njihet me të gjitha hapat, veprimet apo procedurat e ndërmarra nga kjo Palë. Për këtë qëllim, WVA ka të drejtë në çdo kohë të kërkojë dhe të disponojë nga Palët e tjera evidenca, vërtetime, kopje faturash apo pagesash të kryera nga keto Palë si dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm rast pas rasti.

NENI 11 KONFIDENCIALITETI

